



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:118928

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05591098

P.nr.2023:118928

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Samedin Cena, me zyrtarin ligjor Fatlind Kryeziu, në çështjen penale kundër të akuzuarit M.RR., nga fshati ... Komuna e Gjakovës për shkak të veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321, par.1 të KPRK-së, i akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm sipas Aktakuzës me numër PP/II.nr.1627/23 të datës 26.05.2023, në bazë të nenit 357 par. 1 nën par. 1.3 të KPPRK-së si dhe nenit 11 dhe 15 të Ligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, jashtë seance, me datë 18.04.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET Marrëveshja për ndërmjetësim me numër Nd.nr.32/24 e datës 16.04.2024 e lidhur në mes të akuzuarit M.RR., nga fshati ..., Komuna e Gjakovës dhe të dëmtuarit P.GJ., nga fshati ..., Komuna e Gjakovës.
- II. HUDHET Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1627/23 e datës 26.05.2023 dhe PUSHOHET procedura penale ndaj të akuzuarit M.RR., nga fshati ..., Komuna e Gjakovës për shkak të veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321, par.1 të KPRK-së, për shkak se palët kanë arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit.
- III. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP/II.nr.1627/23 të datës 26.05.2023 kundër të akuzuarit M.RR., nga fshati ... Komuna e Gjakovës për shkak të veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321, par.1 të KPRK-së, Komuna e Pejës për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181, par.2 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm më datën 16.04.2024, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në këtë çështje penale në të cilin shqyrtim ishin prezent Prokurori i Shtetit Shqiponja Jupa, pala e dëmtuar P.GJ., me përfaqësuesin e autorizuar avokat Nexhmedin Gashi nga Gjakova dhe i akuzuari M.RR., me mbrojtësen e tij avokate Mone Syla nga Gjakova.

Mbrojtësja e të akuzuarit M.RR., avokate Mone Syla deklaroi se meqenëse ky rast siç shihet në aktakuzë, i akuzuari me palën e dëmtuar janë fqinj, meqenëse vepra penale është përshtatshme për ndërmjetësim i propozoj gjykatës që e njëjta të dërgohet për ndërmjetësim.

Prokurori i shtetit Shqiponja Jupa deklaroi se nuk e kundërshtoj propozimin e avokate Mone Syla mbrojtëse e këtu të akuzuarit M.RR., për dërgimin e lëndës në ndërmjetësim duke e marrë parasysh llojet dhe natyrën veprës, rrethanat në të cilën është kryer, personalitetin e kryerësit, dënimet e mëparshme të tij, nivelin e përgjegjësisë penale, kjo lëndë mund të dërgohet në ndërmjetësim dhe është në interesin e të akuzuarit dhe të viktimës, pasi që marrëveshja mund të arrihet përmes ndërmjetësimit vetëm pasi ka dhënë pëlqimin e i pandehuri M.RR., dhe i dëmtuari P.GJ., andaj bazuar në nenin 229 të KPRK-së nuk e kundërshtoj këtë propozim.

I autorizuari i të dëmtuarit avokati Nexhmedin Gashi deklaroi se pas konsultimeve me të dëmtuarin i njëjti është dakort për të shkuar në procedurën e ndërmjetësimit meqenëse të njëjtit i është shkaktuar dëm material, për të shkuar në procedurë të ndërmjetësimit i dëmtuari kërkon që paraprakisht i akuzuari të ja kompensoj dëmin.

Gjykata pasi mori mendimin e Prokurorit të shtetit Shqiponja Jupa dhe të dëmtuarit P.GJ., me të autorizuarin e tij avokat Nexhmedin Gashi, aprovoi propozimin mbrojtëses së të akuzuarit M.RR., , avokate Mone Syla që kjo çështje juridiko penale të dërgohet në organin e

ndërmjetësimit dhe është ndërprerë shqyrtimi, ndërsa janë udhëzuar palët që këtë çështje ta zgjidhin në procedurën e ndërmjetësimit.

Me datën 16.04.2024, në Gjykatën Themelore në Gjakovë, në prezencën e ndërmjetësuesit Vlora Deva, është lidhur marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar ndërmjet të akuzuarit M.RR., të dëmtuarit P.Gj., .

I akuzuari M.R. ka deklaruar se i vie keq për rastin i cili ka ndodhur në ditën kritike dhe njëherë i kërkon falje duke premtuar se raste të tilla nuk do të ndodhin në të ardhmen.

I dëmtuari P.GJ., deklaroi se e pranon kërkim faljen dhe kërkon që dëmi i shkaktuar në vlerë prej 500 Euro t'i kompensohet.

Palët janë pajtuar që dy dëm në vlerë prej 500 Euro të paguhet, ku i akuzuari ia dorëzoi të dëmtuarit 100 Euro në prezencë të ndërmjetësueses, ndërsa pjesa e mbetur prej 400 Eurove, të paguhet në kate këste. I dëmtuari deklaroi se tërhiqet nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit. Shpenzimet e ndërmjetësimit i pagoi i akuzuari.

Ndërmjetësuesja Vlora Deva me vendimin Nd.nr.32/24 të datës 16.04.2024 ka pranuar marrëveshjen e palëve për zgjidhje të ndërmjetësuar.

Andaj, gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 të Ligjit për ndërmjetësim e aprovoi këtë marrëveshje pasi që të njëjtën e vlerësoi se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve në konflikt dhe në pajtim me ligjin në fuqi. Konform nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësimin me datën e pranimin nga gjykata përkatësisht nga data 18.04.2024, e njëjta do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Gjykata duke u bazuar në provat si më lartë dhe në bazë të nenin 357 par.1 nënpar.1.3 të KPPRK-së dhe nenit 11 dhe 15 të Ligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.2023:118928, me datë 18.04.2024

Numri i lëndës: 2023:118928
Datë: 18.04.2024
Numri i dokumentit: 05591098

Zyrtari ligjor
Fatlind Kryeziu

Gjyqtari
Samedin Cena

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes të kësaj gjykate.